VENDIM
Nr. 169, datë 31.10.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE-s NR. 103, DATË 23.6.2016, "MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me kërkesën e shoqërive OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19, germa "l", ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat, për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.
- OSHEE sh.a., në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik konstaton vështirësi në implementimin në afat të rregullave të përcaktuara në rregulloren "Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", sa i përket ndërtimit të platformës IT.
- Parashikimet e nenit 20 të rregullores "Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", mund të adresohen në marrëveshjen që do të lidhet në përfundim të një procedure prokurimi.
- OSHEE sh.a., në shkresën e saj nr. 24041 prot., datë 21.10.2016, drejtuar ERE-s, ka kërkuar shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s me 60 ditë.
- OST sh.a., është shprehur me shkresën nr. 613 prot., datë 29.9.2016, protokolluar në ERE me nr. 701 prot., datë 30.9.2016, se OST sh.a. është ende në fazën e implementimit të platformës IT *on-line* dhe që referuar kontratës përkatëse parashikohet të jetë funksionale në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2017.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në nenin 20 të rregullores së miratuar me vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".
2. Pika nr. 2, e vendimit 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit

publik", ndryshon, si më poshtë:

- Rregullorja "Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", hyn në fuqi brenda datës 31.1.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., OST sh.a., KESH sh.a., Autoritetin e Konkurrencës dhe MEI-n për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti